



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

PËRMBLEDHJE E PUNËS SË MINISTRISË SË DREJTËSISË
QERSHOR - DHJETOR 2020

Prishtinë, dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

HYRJA	3
LLOGARIDHËNIA NË SISTEMIN E DREJTËSISË	4
STRATEGJIA SEKTORIALE PËR SUNDIMIN E LIGJIT	5
AVANCIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE	6
AGJENDA EVROPIANE	7
AVOKATURA SHETËTËRORE (AVSH).....	8
SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS (SHKK)	9
SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS (SHSK)	11
AGJENCIA PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR	12
MJEKËSIA LIGJORE.....	12
INSPEKTORATI I MD-SË	13
BASHKËPUNIMI JURIDIK NDËRKOMBËTARË	13
TË DREJTAT E NJERIUT DHE PARANDALIMI I DHUNËS	15
DREJTËSIA TRANZICIONALE	16
BUXHETI, FINANCAT DHE BURIMET NJERËZORE	18
STREHIMORJA PËR STREHIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT	19
AUDITIMI I BRENDSHËM	20
KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN	20

HYRJE

Pavarësisht rrethanave të vështira të krijuara si pasojë e pandemisë, Ministria e Drejtësisë gjatë periudhës kohore qershor – dhjetor 2020, ka realizuar progres të dukshëm në shumë fusha brenda fushëveprimit, kompetencës dhe kapaciteteve të saj. Ministria e Drejtësisë është angazhuar në zbatimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për fushën e drejtësisë dhe në realizimin e objektivave, programeve dhe projekteve sektoriale si pjesë e dokumenteve strategjike të saj.

Ky raport i punës së MD-së, ka për qëllim të ofrojë një përmbledhje të punës gjashtë mujore të Ministrisë së Drejtësisë, duke përfshirë të arriturat, progresin gjatë kësaj periudhe kohore si dhe identifikimin e sfidave në këtë dikaster.

Gjatë kësaj periudhe, Ministria e Drejtësisë ka punuar në ndryshime substanciale të legjislacionit në sektorin e drejtësisë, duke rishikuar dhe hartuar Projekt-Kode, Projektligje, Koncept-Dokumente dhe akte tjera nënligjore në fushat të ndryshme të sektorit ligjor.

Fokus i veçantë në këtë raport i kushtohet progresit të Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, i cili ka avancuar në fazën e fundit, atë të finalizimit të Draft Strategjisë për Sektorin e Sundimit të Ligjit. Po ashtu, vlen të theksohet edhe angazhimi i MD-së në përmbushjen e kërkesave që dalin nga Agjenda Evropiane.

Ky raport, paraqet edhe të dhënat për marrëveshjet për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë që Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar me shtetet tjera, si dhe punën e të gjitha departamenteve dhe njësive të MD-së. Gjithashtu, në këtë dokument janë paraqitur edhe të dhënat për Agjencitë e pavarura në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

LLOGARIDHËNIA NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Gjatë periudhës raportuese, një nga prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë ishte llogaridhënia. Për këtë, është dërguar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, propozim/vendimi për themelimin e Grupit Punues për hartimin e modaliteteve dhe skenarëve për çështje të reformës në sistemin e Drejtësisë, me qëllim të adresimit të llogaridhënies duke përfshirë edhe Vettingun, i cili është aprovuar nga Qeveria me datë 15.07.2020.

Grupi Punues ka pasur një përbërje gjithëpërfshirëse, me përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë, organizatat e shoqërisë civile, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Policia, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Oda e Avokatëve të Kosovës, Gjykata Themelore, Gjykata Supreme, Prokuroria Themelore dhe Prokuroria e Apelit, të gjithë në rolin vendimmarrës. Në rol mbështetës kanë marrë pjesë edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Italisë, EULEX dhe Misioni i OSBE-së. Kurse Grupi i Ekspertëve të pavarur sipas pikës 1 të vendimit nr. 08/04 të datës 28.02.2020, janë ftuar disa herë për të qenë pjesë e këtij grupi inkluziv.

Në takimin e parë të Grupit Punues, kryesia iu dha shoqërisë civile, z. Florent Spahija nga KDI. Ky grup ka mbajtur me dhjetëra takime gjithëpërfshirëse për të përpiluar raportin me skenarë dhe modalitete mbi mundësinë e fillimit të një procesi të Reformës në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës. Pas 4 muajsh punë intensive e tërë grupit, raporti u dorëzua nga kryesuesi. Ky raport përmban 79 faqe dhe ka 4 modalitete se si do duhej të zhvillohej procesi i llogaridhënies duke përfshirë edhe Vettingun:

Opsioni i I-rë i cili përmban Status Quo-në e sistemit të drejtësisë, konstaton rregullimin aktual ligjor në bazë të të cilave organizohet dhe funksionon sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor, si dhe konstaton problemet kryesore me të cilat ballafaqohet gjyqësori dhe prokuroria.

Opsioni i II-të ofron disa ndryshime të nevojshme ligjore të cilat do të ndikonin në përmirësimin e besimit dhe të llogaridhënies në veçanti në sistemin gjyqësor dhe atë prokurorial.

Opsioni i III-të, 'mix', thërret në adresimin e përmirësimit të gjendjes së sistemit të drejtësisë si përmes aprovimit dhe zhvillimit të Vetingut, ashtu edhe përmes

ndërhyrjeve të tjera ligjore dhe operative që adresojnë elementet e tjera ku stagon llogaridhënia, performanca dhe efikasiteti i atyre që vënë drejtësinë.

Opsioni i IV-të i cili përfshinë Vettingun, ofron një reformë më rrënjësore që përfshinë verifikimin e integritetit të gjykatësve dhe të prokurorëve në një proces 5 vjeçar, e që ndodh vetëm një herë.

Raporti përfundimtar mbi skenarët e Reformës në Sistemin e Drejtësisë, si dhe rekomandimet e dala nga Rishikimi FunkSIONAL të Sektorit të Sundimit të Ligjit, do të shfrytëzohet si bazë mbi të cilin pastaj Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë, në koordinim me akterët tjerë si dhe partnerët strategjikë do të procedojë tutje me reformë.

STRATEGJIA SEKTORIALE PËR SUNDIMIN E LIGJIT

Rishikimi FunkSIONAL është proces i nisur nga Ministria e Drejtësisë me qëllim të ofrimit të një vizioni gjithëpërfshirës strategjik për një sektor të konsoliduar të sundimit të ligjit, rritjes së besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë, përshpejtimin e zhvillimit ekonomik, dhe përafrimin e Kosovës me Unionin Evropian. Periudha raportuese ka shënuar nisjen e fazës së tretë të Rishikimit FunkSIONAL të Sektorit të Sundimit të Ligjit, gjegjësisht fazës së hartimit të Strategjisë Sektoriale për Sundimin e Ligjit. Kjo fazë pason dy fazat e para të këtij procesi gjatë të cilave janë kryer analizat fillestare të Rishikimit – në formë të analizave paraprake, dhe janë prodhuar gjashtëmbëdhjetë (60) dokumente të politikave. Gjatë gjashtë mujorit që po e lëmë pas, Ministria e Drejtësisë ka punuar vazhdimisht dhe intensivisht në finalizimin e procesit të Rishikimit FunkSIONAL dhe kurorëzimin e këtij procesi me Strategjinë Sektoriale për Sundimin e Ligjit. Faza e tretë e hartimit të Strategjisë Sektoriale për Sundimin e Ligjit është nisur me takimin e grupit qendror për hartimin e Strategjisë për të pasuar me tre takimet e radhës së nëngrupeve tematike për gjyqësorin, drejtësinë penale, qasjen në drejtësi, dhe anti-korrupsionin.

Në fund të vitit 2020, drafti fillestar i Strategjisë Sektoriale për Sundimin e Ligjit pritet të vihet në konsultime publike.


AVANCIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE

Projekt kodet/projektligjet - Ministria e Drejtësisë ka punuar edhe në hartimin e legjislacionit të ri, përfshirë Projekt Kodin Civil të Republikës së Kosovës, Projektligjin për Pronën Publike, Projektligjin për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës, si dhe Projektligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për Çështje Penale, të cilat janë miratuar nga Qeveria.

Po ashtu, MD është në fazën e finalizimit të Projekt Kodit të Procedurës Penale, Projektligjit për Avokaturën Shtetërore, Projektligjit për Provimin e Jurisprudencës, Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Projektligji për Gjykatën Komerciale, Projektligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Projektligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe disa projektligje dhe akte të tjera nënligjore që kanë synim përmirësimin dhe avancimin e sistemit të drejtësisë.

Koncept dokumentet - Me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës ligjore edhe më tej, Ministria e Drejtësisë ka punuar në hartimin e koncept dokumenteve, të cilat i paraprijnë hartimit të projektligjeve, nga disa fusha, përfshirë: *Koncept Dokumentin për Sanksionet e Shënjestruara për Shkelësit e të Drejtave të Njeriut; Koncept Dokumentin për Fondin e Konfiskimit, Koncept dokumentin për Kompensimin e Viktimave të Krimit dhe Koncept Dokumentin për Ekspertizat Gjyqësore.*

Aktet nënligjore - Me qëllim të zbatimit sa më të mirë dhe efikas të legjislacionit në fuqi, MD ka hartuar një numër të akteve nënligjore, përfshirë: *Rregulloren e MD - Nr. 01/20201 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore; Udhëzimin Administrativ për Mbrojtjen Juridike të Personave të Akuzuar Potencial për*



Krimet e Pretenduara në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara; Udhëzimin Administrativ për Mbështetjen e Nevojshme Financiare për Anëtarët e Ngushtë të Familjes së Personave të Akuzuar Potencial për Krimet e Pretenduara në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara,

për Shpenzimet e Ndërlidhura me Udhëtimet e Tyre kur Procedurat Gjyqësore Zhvillohen jashtë Kosovës; Udhëzimin Administrativ për Kompensimin e Personave të Akuzuar për

Krimet e Pretenduara në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara, të Shpallur të Pafajshëm me Vendim të Plotfuqishëm; Rregulloren për Punën e Kuvendit të Odës së Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës; Statutin e Odës së Ndërmjetësuesve të Republikës së Kosovës; Udhëzimin Administrativ për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për Mbrojtjen Juridike të Personave të Akuzuar Potencial për Krimet e Pretenduara në Proceset Gjyqësore Pranë Dhomave të Specializuara; Udhëzimin Administrativ për Lejimin e Pushimit Vjetor për të Miturit; Udhëzimin Administrativ për Ndalimin e Vizitave për Shkaqe të Justifikueshme si dhe Udhëzimin Administrativ për Programin të Drejtat Obligimet dhe Benificionet për të Mitur në Qendrën Edukativo Korrektuese.

AGJENDA EVROPIANE

Agjenda për Reforma Evropiane (ERA I) – Në kuadër të Reformës së Administratës Publike, që ndërlidhët edhe me ERA I, në këto çështje, MD i ka përfshirë në dispozitat përkatëse në dy kodet: Kodin Penal dhe Projekt Kodin e Procedurës Penale. Në Kodin Penal parashihet ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike, personit zyrtar, i cili kryen veprë penale të korrupsionit apo keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Programi për Reforma në Ekonomi (PRE) - Gjatë kësaj periudhe kohore, MD ka qenë e angazhuar për zbatimin e masave që dalin nga PRE. Për këtë qëllim, MD ka marrë pjesë në shumë takime ndërministrare dhe me Komisionin Evropian, ku ka raportuar për zbatimin e masave që dalin nga PRE 2020-2022, më saktësisht “Ulja e ekonomisë joformale në sektorin e pronave të paluajtshme” dhe “Themelimi dhe funksionalizimi i Gjykatës Komerciale”. Gjithashtu, në kuadër të të njëjtit program janë planifikuar, përkatësisht ndryshuar/plotësuar masat për PRE 2021- 2023.

Përgatitja dhe Publikimi i Raportit “Vlerësimi Krahasues të Sistemit Gjyqësor në Kosovës për vitin 2014, 2017, 2018” - Ky raport shqyrton efikasitetin e sistemit gjyqësor të Kosovës të bazuar në metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), dhe vlerëson përparimin e bërë gjatë një periudhe pesë vjeçare (2014 - 2018), përmes tri shtyllave matëse (2014, 2017 dhe 2018). Derisa ky është raporti i tretë i këtij lloji, ai është i pari ku Ministria e Drejtësisë (MD) ka marrë përsipër drejtimin sa i përket mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. Në këtë drejtim, MD ka zbatuar një rekomandim të bërë nga CEPEJ (Rek. nr. 19 i Vlerësimi 2017) dhe ka emëruar koordinatore kombëtarë për CEPEJ me objektiv afatgjatë vendosjen e një procedure të qëndrueshme të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave gjyqësore. Koordinatorët kombëtarë për CEPEJ u mbështetën nga eksperti

ndërkombëtar për CEPEJ dhe Projekti KoSEJ (financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, dhe i implementuar nga Këshilli i Evropës.

AVOKATURA SHETËRORE (AVSH)

Gjatë kësaj periudhe, MD ka punuar në avancimin e infrastrukturës ligjore, përkatësisht hartimin e Ligjit të ri për Avokaturën Shtetërore dhe të Rregullores për Organizim të Brendshëm. Përmes projektligjit të ri, ndër të tjera do të parashihen:

Obligimi për denoncimin e keqpërdorimeve, që kjo është paraparë edhe tek Kodi i Procedurës Penale, por megjithatë, është vlerësuar të jetë e normuar edhe në kuadër të këtij Projektligji, sipas së cilës Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, avokatët shtetëror, obligohen që nëse gjatë kryerjes së detyrave zyrtare hasin në ndonjë shkelje ku ekziston dyshim i arsyeshëm për ndonjë element të veprës penale që ndërlidhet me kategorinë e veprave penale kundër korrupsionit zyrtar dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, të njëjtit ushtrojnë kallëzim penal në pajtim me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Edhe një propozim i ri, i cili ka të bëjë me vlerësimi paraprak të draft kontratave, me ç' rast është paraparë që me kërkesë të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, do të vlerësohet risku i draft kontratave, dhe Avokatura do të jep opinion.


Po ashtu, Avokatura Shtetërore ka përfaqësuar institucionet shtetërore në procedura gjyqësore në rreth 950 raste. Është finalizuar baza e të dhënave, si dhe është drejt finalizimit faqja zyrtare e AVSH-së, veprime këto të cilat do ta rrisin transparencën e këtij institucioni.

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS (SHKK)


Pavarësisht situatës së rënduar për shkak të pandemisë COVID 19, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka qenë i angazhuar maksimalisht për të realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Në këtë drejtim, SHKK ka punuar në angazhimin e infrastrukturës së saj ligjore, përmirësimin e kushteve për të burgosurit, si dhe avancimin e sigurisë për të burgosurit. Gjatë këtyre muajve, Qendrat Korrektuese kanë realizuar disa projekte të paraqitura në tabelën si më poshtë:

Emri i Projektit	Qendra
Ndërtimi i fermës së pulave	Qendra Korrektuese Dubravë
Renovimi i Kuzhinës	Qendra Korrektuese Smrekovnicë
Renovimi i Pavijoni A	Qendra Korrektuese Lipjan
Ndërtimi I Serës	Qendra për femra në Lipjan
Renovimi i kuzhinës administrative	Qendra Korrektuese Dubravë
Instalimi i kadajave	Qendra Korrektuese Dubravë
Rregullimi i ndriçimit dhe zëvendësimi i poçave me efijencë	Institucionet Korrektuese
Rregullimi i dysHEMEVE	Burgun e Sigurisë së Lartë
Furnizimi me material për rregullimin e dysHEMEVE	Institucionet Korrektuese
Renovimi i kulmit në Objektin e Sigurisë	Qendra Korrektuese Dubravë
Asfaltimi i 3 shëtitoreve	Qendra Korrektuese Dubravë
Asfaltimi i perimetrit përgjatë zonës sterile dhe krijimi i vend-parkingjeve për visitor	Qendra Korrektuese Dubravë

Pranimet e të burgosurve në Institucionet korrektuese gjatë periudhës qershor-nëntor 2020 - Sipas raportimeve nga Institucionet Korrektuese, gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsejtë **1415** të burgosur nëpër Institucionet Korrektuese. Prej tyre kanë qenë: **458** të dënuar (madhorë), **1** i mitur i dënuar, **1** e dënuar (Femër), **917** paraburgosur (madhorë), **4** të paraburgosura (Femra), **24** të mitur të paraburgosur dhe **24** të mitur me masë edukative.



Lirimet e të burgosurve nga Institucionet Korrektuese gjatë periudhës qershor-nëntor 2020 - Sipas raportimeve nga Institucionet Korrektuese, gjatë muajit periudhës në fjalë, janë liruar gjithsejtë **1446** të burgosur. Prej tyre kanë qenë: **545** të dënuar madhorë, **2** të dënuara (femra), **15** të mitur me masë edukative, **866** të paraburgosur (madhorë), **3** të paraburgosura (Femra), **14** të paraburgosur (të mitur) dhe **1** i mitur i dënuar.



SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS (SHSK)

Në periudhën qershor-dhjetor 2020, Shërbim Sprovues i Kosovës (SHSK) ka realizuar detyrat sipas dinamikës së paraparë, duke pas parasysh edhe rrethanat me pandeminë COVID-19. Ndër prioritet kryesore gjatë vitit 2020 kanë qenë: mbikëqyrja e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative, mbikëqyrja e të liruarve me kusht nga burgu; ngritja e vetëdijes së opinionit profesionist për rëndësinë e shqiptimit të masave dhe dënimeve alternative, si dhe ngritja e kapaciteteve të brendshme.

Duke pas parasysh këto prioritete, SHSK ka vazhduar me mbikëqyrjen e rasteve me masa dhe dënime alternative duke respektuar afatet dhe kushtet e parapara me vendime gjyqësore. Gjatë kësaj periudhe, SHSK ka mbikëqyr një numër të madh të rasteve me masa, dënime alternative si dhe persona të liruar me kusht.

Tabela në vazhdim pasqyror me saktësi numrin e rasteve si dhe llojet e rasteve gjatë kësaj periudhe:

<i>Numri i rasteve për periudhën qershor-dhjetor 2020</i>		
Nr.	Lloji i rastit	Total
1	Anketë sociale	936
2	Masë edukative	368
3	Dënimi me kusht	351
4	Masë e trajtimit të detyrueshëm	39
5	Lirim me kusht	348
6	Raport para ndëshkues	4
7	Masë e diversitetit	370
8	Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme	86

AGJENCIA PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK), ka ekzekutuar gjithsej 92 vendime të dërguara nga Gjykatat Kompetente, për administrimin e pasurisë të sekuestruar ose të konfiskuar. Nga këto vendime, 54 vendime janë për sekuestrim, 22 vendime për konfiskim, 16 vendime për kthimin e pasurive. Gjithashtu, nga 6 ankande dhe janë realizuar të hyra nga shitja në shumën e përgjithshme prej 33,807.00€.

Po ashtu, AAPSK ka hartuar draftin e koncept dokumentit për themelimin e Fondit të Konfiskimit, qëllimi i të cilit është të mundësohet krijimi i infrastrukturës së përgjithshme ligjore për përdorimin e pasurive të konfiskuara përmes themelimit të një fondi të konfiskimit, përdorimi i pasurisë së konfiskuar nga institucionet që merren me zbatimin e ligjit dhe ri-përdorimit social si dhe shfrytëzimin për kompensimin e viktimave të krimit. Drafti do të përkthehet për avancim të mëtejshëm dhe konsultime brenda grupit dhe më pas ato publike.


MJEKËSIA LIGJORE

Ristrukturimi i Institutit për Mjekësinë Ligjore (IML) - Me qëllim të funksionalizimit të plotë të IML, Ministria e Drejtësisë ka miratuar rregulloren Nr. 01/20201 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore. Në të njëjtën kohë, është hartuar drafti i parë i Strategjisë për zhvillimin e IML-së. Po ashtu, me qëllim të avancimit dhe përmirësimit të punës së Institutit, ka nisur hartimi i analizës së mangësive dhe vlerësimi i nevojave për trajnimin e stafit. Përveç kësaj, është hartuar edhe një broshurë informuese për profesionistët shëndetësor, lidhur me identifikimin dhe dokumentimin e dëmtimeve të viktimave dhe dhunës në familje.

Në kuadër të projektit “MA THUAJ ME KOHË”, janë mbajtur edhe tri ligjërata për nxënësit e shkollave të mesme, duke përdorur platformat online, për shkak të pandemisë.

Puna e IML-së - përveç angazhimit në reformën strukturore dhe organizative, IML ka vazhduar t’i kryejë detyrat e saj që dalin nga Plani i Punës së Ministrisë Drejtësisë.

Në këtë drejtim, IML ka zbatuar të gjitha urdhëresat për zhvarrime, autopsy, ekzaminime klinike dhe analiza nga laboratorit i toksikologjisë.



Siç shihet në tabelën më lartë, janë zbatuar të gjitha urdhëresat për zhvarrime, duke marrë pjesë në **15** lokacione ku prej tyre, **12** lokacione në Republikën e Kosovës dhe **3** lokacione në Republikën e Serbisë. Si rezultat i këtyre zhvarrimeve janë gjetur gjithsej **11** trupa- mbetje mortore. Po ashtu, janë kryer **autopsi** për **230** raste, **ekzaminime klinike** për **62** raste, si dhe janë punuar **138** analiza nga laboratorit i toksikologjisë (Droge+Barna në gjak dhe urinë, test i shpejtë i drogës, analiza të alkoolit në gjak, urinë dhe vitreus).

INSPEKTORATI I MD-së

Inspektorati ka realizuar inspektime periodike sipas dinamikës së paraparë në fusha të ndryshme si: transferimi i të dënuarve, ushtrimi i ankesave, angazhimi në programin e shkollave dhe risocializimit, funksionimi i komisioneve disiplinore, ekzekutimi i masës së ndëshkimit dhe kthimi në regjime, dhe çështje të tjera, duke u identifikuar shkeljet dhe njëkohësisht janë dhënë rekomandimet adekuate.


BASHKËPUNIMI JURIDIK NDËRKOMBËTARË

Fusha e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtarë është ndikuar në masë tepër të madhe nga pandemia Covid-19. Pavarësisht këtij fakti, edhe në këtë fushë, MD ka shënuar disa të arritura gjatë pjesës së dytë të vitit 2019. Arritja më madhore për këtë periudhë është themelimi i bashkëpunimit me EUROJUST. Pas përpjekjeve të vazhdueshme për të themeluar bashkëpunimin, më 03.12.2020, është mbajtur një konferencë me EUROJUST-in, ku është diskutuar rreth mundësive të konkretizimit

të këtij bashkëpunimi. Si rrjedhojë, menjëherë në muajin dhjetor janë caktuar pikat e kontaktit dhe shkëmbimet e para rreth bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Përgjatë pjesës së dytë të vitit, fusha e bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë është avancuar përmes disa nismave të suksesshme legislative, duke vepruar në drejtim të rregullimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile me akte të veçanta.

Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtarë në kuadër të MD-së ka finalizuar draft-projektligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile, si dhe ka negociuar dhe finalizuar dy marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile, me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Këto dy marrëveshje, janë të parat marrëveshje të tilla të reja për Republikën e Kosovës. Po ashtu, përgjatë periudhës në fjalë janë procesuar gjithsej **2254** kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike, prej të cilave **1374** nga autoritetet vendore gjyqësore drejtuar shteteve të huaja dhe **880** kërkesa nga autoritetet gjyqësore të huaja drejtuar Kosovës, si dhe janë realizuar gjithsej **28** ekstradime, prej të cilave **12** nga Kosova dhe **16** anasjelltas, nga shtetet tjera për në Kosovë.



TË DREJTAT E NJERIUT DHE PARANDALIMI I DHUNËS

Fushata e vetëdijesimit - Ministria e Drejtësisë, përmes Zyrës së Koordinatorit Nacional Kundër Dhunës në Familje, ka organizuar fushatën kundër dhunës në familje në kuadër të fushatës “16 Ditët e Aktivizmit”. Fushata është mbështetur nga UN Women dhe EULEX-i, gjatë së cilës janë organizuar një varg aktivitete, përfshirë dy video spote për TV dhe Radio, billborda, ndriçimi i ndërtesës, punëtori dhe konferenca, në të cilat janë trajtuar tema për dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore. Po ashtu, me rastin e shënimit të 25 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, që simbolizohet me "**kordelen e bardhë**", Ministria i është bashkangjitur fushatës së “16 Ditëve të Aktivizmit”, duke vendosur në ueb faqen e saj "Fjongon e Bardhë" prej datës 25 Nëntor deri me 10 Dhjetor 2020.

Monitorimi dhe zbatimi i legjislacionit - Ministria e Drejtësisë është angazhuar në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjit për Barazi Gjinore, si dhe ka koordinuar punën në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Po ashtu, MD ka monitoruar zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit 2016-2020, Planit të Veprimit për të Drejtat e Komunitetit LGBTI 2019-2022, Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2018-2020, si dhe ka qenë pjesë e hartimit të draft Planin Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023.

Data baza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje- Ministria e Drejtësisë gjatë viti 2020 ka ndërmarr disa aktivitete për zhvillimin e aplikacionit dhe përditësimin e të dhënave. Gjatë këtij vitit, aplikacioni “Baza e të dhënave për evidentimin e rasteve të dhunës në familje”, është ri-dizajnuar dhe zhvilluar sipas kërkesave që janë evidentuar gjatë takimeve dhe trajnimeve të shumta që janë mbajtur me akterë relevantë.

Po ashtu, gjatë gjithë kohës së pandemisë janë mbajtur takime online me institucione që kanë shprehur nevojën për trajnime dhe sqarime të detajueshme në lidhje me funksionimin e data-bazës për evidentimin e rasteve të dhunës në familje, gjë e cila ka kontribuar edhe në zhvillimin e mëtejshëm të aplikacionit. Pas zhvillimit të data-bazës për evidentimin e rasteve të dhunës në familje, në pamundësi të zhvillimit të

takimeve/trajnimeve nga afër për shkak të pandemisë, MD ka përpiluar një manual për strehimoret me të gjitha procedurat që ato duhet të ndjekin hap pas hapi.

Ky manual përfshinë komplet procedurën e regjistrimit të një rasti si dhe kalkulimin e numrit të ditëve të qëndrimit të viktimës (së bashku me fëmijët) në strehimore me anën e shembujve testues. Ky dokument është dërguar tek të gjitha qendrat e regjioneve: Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe Ferizaj.

DREJTËSIA TRANZICIONALE

Strategjia Nacionale për Drejtësi Tranzicionale - Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës nuk ka ndonjë dokument strategjikë, gjithëpërfshirës, që do t'i adresonte objektivat dhe qëllimet e Drejtësisë Tranzicionale, MD ka filluar punën për hartimin e Strategjisë Nacionale për Drejtësinë Tranzicionale. Strategjia Nacionale për Drejtësi Tranzicionale do të përfshijë katër shtyllat e drejtësisë tranzicionale: të drejtën për t'u informuar, të drejtën për reparacione/dëmshpërblim, garancitë e mos përsëritjes dhe reforma institucionale. Nevoja për një dokument të tillë strategjik është paraqitur edhe në Raportin për vendin të Komisionit Evropian për vitin 2020, në të cilin thuhet se *“Kosova ka nevojë të zhvillojë një strategji gjithëpërfshirëse për drejtësinë tranzicionale, duke përfshirë një qasje gjithëpërfshirëse për adresimin e së kaluarës së saj”*.

Ri-themelimi i Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë - Krimet dhe dëmet e luftës janë vetëm një pjesë e fushës së Drejtësisë Tranzicionale. Prandaj, Ministria e Drejtësisë ka iniciuar ri-themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, duke caktuar edhe anëtarë në Grupin Punues. Aktualisht, bazuar në Rregulloren QRK Nr.12/2018, në kuadër të MD-së funksionon Departamenti për Drejtësi Tranzicionale, i cili ka trashëguar nga ish Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës asetet, dokumentacionin dhe bibliotekën.

Kompensimit i Viktimave të Krimit - Në kuadër të Departamentit për Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit, funksionon Divizioni për Mbështetjen e Viktimave të Krimit(MVK), i cili ka rol administrativ dhe teknik për Komisionin Qeveritar për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Nga qershori i këtij viti, Divizioni MVK-it ka trajtuar **55** raste të paraqitura, nga të cilat **22** janë aprovuar. Vlen të theksohet se si pasojë pandemisë Covid-19, për të gjitha rastet, vendimet janë marrë në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2020-të.


Kërkesat - 2020	Nr. i kërkesave	Lloji i veprave penale		Të refuzuar	Të aprovuara	Lëndë aktive
Rastet e pranuar gjatë vitit 2020	55	• Vrasje:	17	28	22	5
		• Vepër Penale. tjetër:	7			
		• Dhunim:	5			
		• Dhunë në familje:	8			
		• Lëndime të rënda:	3			
		• Keqtrajtim seksual i fëmijëve	3			
		• Ngacmim seksual	2			
		• Trafikimi me qenie njerëzore	4			
		• Lëndim i lehtë trupor	2			
		• Grabitje	1			
		• Vrasje e rëndë në tentativë	3			

Vlera totale e Kompensimit				91,935.13 €	
----------------------------	--	--	--	-------------	--


BUXHETI, FINANCAT DHE BURIMET NJERËZORE

Buxheti dhe financat - Divizioni për Buxhet dhe Financa në Ministrinë e Drejtësisë veprimtarinë e vetë e kryen bazuar në ligjin nr. 04/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të Republikës së Kosovës, dhe Rregullores QRK-Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.


Buxheti i miratuar për vitin 2020 për Ministrinë e Drejtësisë ka qenë në vlerën prej **29,853,812.00 €**. Shpenzime të realizuar për periudhën Janar-Dhjetor 2020 janë në vlerën prej **19,741,767.27 €**.



Trajnimet profesionale - Pavarësisht situatës me pandeminë, me qëllim të avancimit dhe përgatitjes më të mirë profesionale të stafit të MD-së, gjatë periudhës në fjalë janë realizuar gjithsej 10 trajnime. Duhet të theksohet se të gjitha këto trajnime janë realizuar përmes platformave online.



Derivatet dhe shpenzimet – Gjatë vitit 2020, MD ka shpenzuar 10,761 litra derivate për nevojat e institucionit ndërsa 9,056 euro janë shpenzuar për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve të Ministrisë.



STREHIMORJA PËR STREHIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Pas miratimit të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, në kuadër të nen-kodit programor 36800 është vendosur Strehimorja, e cila tani me këtë ligj bie nën kodin e organizatës: MD 215. Njëkohësisht, me Rregulloren e Qeverisë 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në shtojcën 8, pika 13, Strehimorja Shtetërore është transferuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Ministrinë e Drejtësisë. Strehimorja për Strehimin e Viktimave të Trafikimit e cila gjendet në Lipjan, punon 24 (njëzet e katër) orë në ditë dhe

akomodon/strehon viktimat e trafikimit me rrezikshmëri të lartë dhe të mesëm të sigurisë, si dhe dëshmitare të mbrojtura në cilësinë e viktimës së trafikimit.

Viktimat e strehuara gjatë vitit 2020 - Gjatë vitit 2020, në Strehimore janë strehuar gjithsej nëntë (9) viktima të trafikimit. Sipas Formës Bazike të të Dhënave nga Policia e Kosovës/ DHTQNJ, ishin të gjitha viktima të trafikimit. Në ndikim të substancave narkotike ishte një (1) viktimë mashkull i moshës tetë (8) vjeç.

Të gjinisë femërore kanë qenë shtatë (7) ndërsa të gjinisë mashkullore dy (2). Sipas moshës dhe prejardhjes kanë qenë 8 të moshës së mitur; 1 moshë madhore; 6 ishin vendore dhe 3 ndërkombëtare.

AUDITIMI I BRENDSHËM

Për periudhën qershor – dhjetor të vitit 2020, janë realizuar këto auditime sipas planit vjetor të punës së Njesisë për Auditim të Brendshëm (NjAB):

1. Procedurat e Personelit
2. Menaxhimi i Pasurive
3. Shpenzimet e Ushqimit, higjienës dhe parasë se imët për SHKK.

Gjatë vitit 2020 NjAB, ka dhënë gjithsej rreth 12 rekomandime, ndërsa menaxhmenti i MD-se ka zbatuar 8 rekomandime dhe 4 janë në proces të zbatimit.

KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN



Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, gjatë periudhës qershor – dhjetor 2020 Ministria e Drejtësisë ka qenë e përkushtuar që në vazhdimësi t'i ofrojë publikut pasqyrë të punës dhe aktiviteteve të Ministrisë. Përveç

komunikatave të vazhdueshme për media, konferencave dhe takimeve me përfaqësues të institucioneve të ndryshme nga sistemi i drejtësisë dhe jo vetëm, MD i

ka kushtuar rëndësi të veçantë trajtimit të kërkesave nga publiku për çështje të veçanta, përfshirë kërkesat për qasje në dokument zyrtarë. Gjatë kësaj periudhe, MD ka ofruar qasje në dokumente publike të saj për të gjitha 14 subjektet, të cilat kanë bërë kërkesë për një gjë të tillë.

Faleminderit!

Ministria e Drejtësisë